Kronikë

Tiranë/ 30 plumba kallashnikovi fasadës së 'CFO Pharma'! Kamerat 'kapin' një makinë të errët, pronari: Nuk kam konflikte (VIDEO)

30 plumba kallashnikovi u qëlluan gjatë natës në fasadën e kompanisë farmaceutike "CFO Pharma" në Tiranë, fatmirësisht pa asnjë të dëmtuar në. Nga kamerat rezulton të jetë qëlluar nga një makinë, e cila u largua në drejtim të mbikalimit të Kasharit, ndërsa roja i sigurisë dëgjoi zhurmën. Pronari Nadir Çausholli pretendoi se nuk kishte probleme dhe nuk dinte kush janë autorët.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sokol Dema
18 Mars, 11:27 | **Përditesimi: 18 Mars, 18:56**

Share

TIRANË- 30 plumba kallashnikovi u qëlluan rreth orës 02:00 të mëngjesit në fasadën e kompanisë farmaceutike "CFO Pharma" në Tiranë, fatmirësisht pa asnjë të dëmtuar. Për fat të mirë askush nuk u lëndua, gjatë natës godina është bosh. Ishin punonjësit e kompanisë, të cilët pasi mbërritën në orën 08:00 në punë, panë shenjat e plumbave, për të cilat njoftuan policinë.

Nga këqyrja e pamjeve të kamerave, ngjarja kishte ndodhur 6 orë më herët, dhe roja i sigurisë, edhe pse ndodhej në kabinën e tij, nuk mundi të kuptonte se ishte qëlluar me armë. Sipas tij, dëgjoi një zhurmë, doli jashtë por nuk pa njeri dhe rrjedhimisht nuk telefonoi policinë. Blutë, pasi verifikuan kamerat panë një makinë të errët, e cila rreth orës 02:00 afrohet pranë godinës dhe nga brenda nis të qëllojë për disa sekonda, dhe më pas niset me shpejtësi të mbikalimit të Kasharit, duke humbur gjurmët.

Autoritetet kanë nisur hetimet intensive për zbardhjen e ngjarjes, por deri më tani nuk ka asnjë të dyshuar. Pamjet e kamerave janë të turbullta, pasi në momentin që është qëlluar, po binte shi i lehtë, i cili vështirësON pamje. I pyetur për rastin, pronari i kompanisë "CFO Pharma", Nadir Çausholli, u tha hetuesve se nuk e dinte kush mund të jenë autorët e kësaj ngjarjeje, e cila mund të kishte rezultuar fatale. Sipas tij, nuk ka konflikte me njeri. Hetuesit dyshojnë se plumbat në fasadën e kompanisë mund të jenë një mesazh direkt për pronarin, por hetimet do të zbardhin në vijim shkakun e plotë.

LEXO EDHE:
Kundërshtoi dhe goditi policin, arrestohet 31-vjeçari në Tiranë (EMRI)

> *"Rreth orës 08:10, në sallën operative të DVP Tiranë, ka ardhur njoftimi se në rrugën dytësore të autostradës "Durrës – Tiranë", gjatë natës, dyshohet se është qëlluar me armë zjarri në drejtim të fasadës së një ndërtese. Nga të shtënat janë shkaktuar vetëm dëme materiale", njoftoi Policia e Tiranës.*

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: te shtena me arme | CFO Pharma | Tirane | Nadir Causholli

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 17 Mars, 09:11

Mendoni se Parlamenti i dalë nga zgjedhjet e 11 majit do të jetë më cilësor?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

'E gjetëm të shkretuar dhe me stola të thyer!' Veliaj kujton ndërtimin e Amfiteatrit Veror 7 vite më parë: Çibanët kishin mbirë në çdo cep te Liqeni, tani oaz arti e kulture

19 Mars, 10:05

Stërvitja e fundit, Sylvinho me një mungesë! Brruti regjistrohet në FIFA, Kombëtarja niset sot drejt Londrës

19 Mars, 09:35

Tiranë/ Zbulohet shtëpi bari në Laknas, PAMJET e mbushur plot me kanabis! Në pranga 2 vëllezërit e kthyer nga Anglia dhe punonjësi i OSHEE! Pajisje të sofistikuara për kultivim (EMRAT)

19 Mars, 08:22

'Celulë më celulë'/ Rama mbyll ditën nga Njësia 7, ironizon Bashën: Ai më vdes fare, më thotë 'Rame ku i ke shokët', ndërkohë vetë del tek pull

18 Mars, 23:06

Zbulohet një shtëpi bari në Laknas/ Arrestohet një punonjës i OSHEE, shoqërohen dhe dy vëllezër

18 Mars, 22:38

Lorenc Vangjeli: Dilema e Ramës, redaktor i Veliajt apo kryeredaktor i listës

Lorenc Vangjeli

18 Mars, 21:20

'Pse më shikon ashtu', sherri mes të miturve në Kamëz! Arrestohet 17-vjeçari që plagosi me thikë bashkëmoshatarin

18 Mars, 14:35

Hakmarrje primitive, FSHF lë Kombëtaren pa ultras! Anëtari i TKZ për Report TV: Na thanë mos kundërshtoni Euro 2027 me Serbinë, mungojmë në 'Wembley'

18 Mars, 13:03

Ndeshja kundër Anglisë, Asllani: Në Londër s'shkojmë për turizëm, duam Botërorin! Bajrami: Të mësojmë nga gabimet

18 Mars, 12:01

Tiranë/ Grabiti lokalin dhe tentoi të vidhte dy makinat e parkuara aty pranë, arrestohet 47-vjeçari

18 Mars, 11:40

Ekstradohet nga Spanja ish-kreu i bandës së Durrësit, Lulzim Berisha akuzohet për vrasjen e rivalit Klodian Saliu (VIDEO)

Sokol Dema

18 Mars, 11:33

Shqipëria, Kosova dhe Kroacia, marrëveshje trepalëshe ushtarake

18 Mars, 10:58

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje